



Zyra e Shtypit
17 prill 2008

Mbi ndërhyrjet në tregun e parasë dhe në tregun valutor gjatë tremujorit të katërt të vitit 2007

1. NDËRHYRJET NË TREGUN E PARASË

1.1. Operacionet e tregut të hapur.

Tabelë 1: Vëllimi i operacioneve të tregut të hapur (në milionë lekë).

DATA	Injektim likuiditeti	Tërheqje likuiditeti
	R/REPO njëjavore	REPO njëditore
04.10.2007	0.00	
11.10.2007	0.00	1,000.00
18.10.2007	0.00	
25.10.2007	3,000.00	
01.11.2007	4,000.00	
08.11.2007	1,450.00	
15.11.2007	3,880.00	
22.11.2007	5,500.00	
30.11.2007	6,400.00	
06.12.2007	4,300.00	
13.12.2007	3,300.00	
21.12.2007	2,350.00	
27.12.2007	0.00	

Ndërhyrjet në tregun e parasë gjatë tremujorit të katërt të vitit 2007 përfshinë operacione të tregut të hapur, kryesisht për injektimin e likuiditetit në përgjigje të mungesës së tij në sistemin bankar.

Për të injektuar likuiditet, Banka e Shqipërisë ka përdorur gjatë gjithë periudhës *marrëveshjen e anasjelltë e riblerjes me maturim njëjavor*. Nëpërmjet saj janë injektuar mesatarisht 3.8 miliardë lekë në javë.

Për tërheqjen e tepicës së përkohshme të likuiditetit, Banka e Shqipërisë ka përdorur instrumentin e *marrëveshjes së riblerjes me maturim njëditor*, vetëm në një rast.


1.2. Përdorimi i instrumenteve mbështetëse.

Gjatë tremujorit të katërt të vitit 2007, për investimin e likuiditeteve të lira, bankat përdorën depozitën njëditore, niveli mesatar ditor i të cilës ishte 1.34 miliardë lekë, në nivel të përafërt me tremujorin e kaluar (1.61 miliardë lekë).

Në kushtet e plotësimit të nevojave në tregun ndërbankar, instrumenti i kredisë njëditore gjeti përdorim minimal gjatë këtij tremujori, rreth 0.06 miliardë lekë në 5 raste përdorimi.

Grafiku i mëposhtëm paraqet në mënyrë të përmbledhur ndërhryjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë, gjatë vitit 2007.

Grafik 1: Ndërhryjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë gjatë vitit 2007.



2. NDËRHRYJET NË TREGUN E BRENDSHËM VALUTOR

2.1 Veprime me bankat e nivelit të dytë.

Gjatë tremujorit të fundit të vitit të kaluar, monedha vendase ka vazhduar të forcohet kundrejt atyre të huaja. Rënia e valutave gjatë kësaj periudhe ka qenë graduale dhe ka ndaluar gjatë dhjetorit. Banka e Shqipërisë ka qenë e pranishme në tregun valutor duke blerë valutë nga bankat e nivelit të dytë. Ndërhryja gjatë këtij tremujori ka synuar

plotësimin e Rezervës Ndërkombëtare Neto. Në plotësim të këtij objekti, ndërhyrja e Bankës së Shqipërisë ka konsistuar në shitjen e 890.79 milionë lekë. Kjo shumë është ndjeshëm më e vogël se një tremujor më parë dhe se e njëjta periudhë e një viti më parë.

2.2 Veprime me institucione të tjera.

Gjatë kësaj periudhe kanë vijuar të realizohen veprime të shitjes dhe të blerjes së valutës me Ministrinë e Financave. Shitjet e valutës gjatë këtij tremujori kanë qenë 397.32 milionë lekë, ndërsa blerjet 4,774.31 milionë lekë.

Blerjet e valutës nga institucionet e huaja llogariten në 91.89 milionë lekë (Agjencia Ndërkombëtare për Zhvillim, IDA dhe Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, IBRD).

Institucioni financiar	Blerje të valutës	Shitje të valutës
MINISTRIA E FINANCAVE	4,774.31	397.32
TE TJERA (IDA, IBRD)	91.89	-